



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2022:193952

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06264381

P.nr.158/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, sipas Gjyqtares së vetme gjykuese Sabrije Rraci, me pjesmarjen e Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në lëndën penale kundër të pandehurit A G nga D i akuzuar për vepër penale, Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPKR-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II.nr.1663/2022, e datës 30.09.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala, si dhe të pandehurit të lartëcekur mbrojtësi i të pandehurit ex officio av.Marjan Nrecaj me dt.30.09.2024, të njëjtën ditë e shpalli ndërsa e përpiloi me dt.08.10.2024, këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër:

Te pandehurit A G i lindur më , në D- K.Deçan, ku dhe tani banon, me numër personal,i biri i A G dhe nënës S G e gjinisë L, ka të kryer Fakultetin dhe masterin, posedon biznes individual, i gjendjes së mesme ekonomike, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Kosoves, mrbohet ne liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Më datë rreth orës në rrugën J, tek Lnë nga pakujdesia shkel ligjin për rregullat e trafikut rrugor 05/L-088 dhe me këtë i shkakton lëndim të rëndë trupor këtu të dëmtuarës L Gnë atë mënyrë që gjersa i pandehuri A G ditën kritike ishte duke drejtuar automjetin A),,NT,, me ngjyrë të gjelbërt me targa - cili ishte duke qarkulluar në rrugën , me të arriturat në lagjen G në J, me veprimin e tij të pakujdesshme duke mos ju përshtatur kushteve të rrugës si dhe shpejtësisë, humb kontrollin mbi automjet dhe nga shiriti i djathët kalon në shiritin e kundërt të majtë duke ia marrë përparësinë e kalimit automjetit B) në pjesën e parë ku pos dëmeve materiale pasagjerët e veturës B) Sh G, Xh G,E G dhe E G pësojnë lëndime të lehta trupore, ndërsa lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohëshme për shëndet pëson e dëmtuara L G siç konstatohen në ekspertizën mjeko-ligjore.

Me çka ka kryer vepër penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 40 par 3, 43 dhe 69, 70 si dhe nenit 370 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

#### DENIM ME BURGM ZEVENDESOHET ME DENIM MË GJOBË

I akuzuari A G, dënohet me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim, gjykata konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, të cilën shumë është i obliguar t'i paguajë me dy (2) rata, në fillim të çdo muaji vijues prej datës 01 deri me 05, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) Euro të pa paguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim, konform nenit 43 të KPRK-së.

IV. DËNIM PLOTËSUES: I shqiptohet konform nenit 64 par.1 dhe 2 të KPRK-së, ndalimi i drejtimit të automjetit në kohëzgjatje prej një (1) viti.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompensim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, shpenzimet për ekspertizë mjeko ligjore 20 (njëzet) €, shpenzimet për ekspertizë të komunikacionit 30 (tridhjet) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

III.Udhëzohën: Palët e dëmtuara L G, Xh G , nga J E G, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

### A r s y e t i m

#### 1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën me numër PP/II.Nr.1663/2022, e datës 30.09.2022 kundër të pandehurit A G nga De rruga i akuzuar për vepër penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPKR-së.

Kompetenca e gjykatës, jykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështirimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPK-së, kompetencë territoriale për tu gjykuar një çështje juridiko-penale, ku gjykata në teritorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryehet vepra penale, apo në teritorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale është kryer në J, pasi nga kjo lëndë është përjashtuar gjykata e Deqani, është dërguar tek ne përmes kryetarit të HJTH Pejë, andaj Gjykata Themelore në Pejë dega në Klinë, ka bërë gjykimin e kësaj çështje penale.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt. gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala, mbrojtësi i te pandehurit av.Marjan Ndrecaj si dhe i akuzuari A G.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri A G, i pandehuri dekalron se e pranoj fajësinë për veprën penale në aktakuzë që me vihet ne barrë, jam i penduar thellë për veprën që e kam kryer, i premtoj gjykatës se ne të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tilla.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që e pandehuri A G e pranoj fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të tillë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë nga e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barre, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta marr si rrethanë lehtësuese.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit av.Marjan Ndrecaj ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim, deklaroj se pajtohem me pranimin e fajësisë që e bëri, i cili pranim është konform dispozitave ligjore, dhe i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë si është e cekur edhe në aktakuzë gjëja për të cilën kanë dëshmuar edhe personat madhor në këtë rast ditën kritike kushtet atmosferike nuk kanë qenë të vulltëshme për ngasje të automjetit gjë për të cilën si shkaktar për këtë aksident janë kushtet atmosferike. I pandehuri në këtë rast me të dëmtuarit janë bashkëvendas dhe të njëjtit janë pajtuar dhe personat madhor në këtë aksident deklarojnë se i pandehuri klienti im Albanik ka pas kontakt me të të dëmtuarit dhe është interesuar për gjendjen e tij shëndetësore, njëherit ju ka ofruar ndihmë për shërim.

Sa i përket lëndimeve të njëjti ka deklaruar se në fillim lëndimet kanë qenë të cilësuar si lëndime të lehta trupore por më nderkohë janë shëndërruar në të rënda, me këto nuk pajtohet por së fundmi i njëjti është i penduar për rastin që ka ndodhur, po ashtu i njëjti nuk është recidivist special për qfardo veprë penale, kërkoj nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë, pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim deklaroj se pajtohem me pranimin e fajësisë që e bëri i cili pranim është konform dispozitave ligjore dhe i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë ta aprovoj dhe ta marrë si rrethanë lehtësuese në matjen dhe lartësinë e dënimit dhe të bëjë sipas mundësisë zbutjen e dënimit në përputhshmëri me rregullat e zbutjes së dënimit të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, për vepër penale, Rrezikim i trafikut publik nga neni 370 par.8 e lidhur me par.6 dhe 1, si të KPKR-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjyqimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

### 5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjukata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, si dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri nga ajo ditë nuk ka kryer vepër tjetër

penale, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale, si rrethan tjetër lehtësuese gjykata muarr se i pandehuri vuan nga sëmundja e epilepsisë. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti asnjë rrethanë.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar, gjykata vlerësoi se është dënim i drejtë.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË

Departamenti i Përgjithshëm Penal

P.nr158/2023 me datë.08.10.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja Gjykuese

Sabrije Rraci

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.